



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

ANKESË MBI LICENCËN APO AUTORIZIMIT¹

Ankesë për:

- Vendimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) për mosdhënien e licencës/autorizimit për shërbim audio/audioviziv
- Vendimin e AMA-s për mosrinovimin e licencës/autorizimit për shërbim audio/audioviziv
- Vendimin e AMA-s për heqjen e licencës/autorizimit për shërbim audio/audioviziv
- Vendimin e AMA-s për rrëzimin e ankimit administrativ mbi sanksionin e miratuar ndaj subjektit (gjobë/pezullim licence/autorizimi/reduktim i afatit të licencës/autorizimit).

Pavlefshmëria/heqja e licencës dhe/ose autorizimit

Bazuar në ligjin nr. 97/2013, AMA ka kompetencë të bëjë të pavlefshme licencën dhe/ose autorizimin kur:

- a) mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;
- b) i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit;
- c) AMA ka nxjerrë vendim për heqje licence dhe/ose autorizimi në bazë të kompetencave që i jep ky ligj;
- ç) deklarohet falimentimi;
- d) kërkuesi nuk e tërheq licencën dhe/ose autorizimin ose nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj;
- dh) ka një vendim të formës së prerë nga gjykata që ndalon ushtrimin e aktivitetit nga i licencuari dhe/ose i autorizuari.

Nga ana tjetër, AMA ka të drejtë të heqë licencën dhe/ose autorizimin kur:

1. Është fituar sipas të dhënave të rreme të paraqitura në kërkesë.
2. Nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në licencë.
3. Nuk paguan detyrimet financiare të licencës për një vit.
4. Nuk ka filluar transmetim pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe:
 - a) 6 muaj në transmetimet audio lokale e rajonale;
 - b) 9 muaj në shërbimin e transmetimit audioviziv lokal e rajonal;
 - c) 12 muaj në vënien në funksionim të multipleksit lokal e rajonal;
 - ç) 12 muaj në transmetimet audio kombëtare;
 - d) 18 muaj në shërbimin e transmetimeve audiovizive kombëtare;
 - dh) 24 muaj në vënien në funksionim të multipleksit kombëtar.
5. Pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik, nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës.

¹ ***Paraqitja e ankesës në formë elektronike nuk përjashton detyrimin e subjektit për të depozituar ankimin administrativ në formë shkresore dhe në përmbushje të kërkesave të parashikuara nga K.Pr.Administrative.***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

6. Te mbajtësi i licencës kanë ndodhur ndryshime që e bëjnë të pamundur respektimin e kushteve të vendosura në licencë.

7. Prona e mbajtësit të licencës, e cila shërben drejtpërdrejt për ushtrimin e aktivitetit të shërbimeve audiovizive, ka dalë në ankand për shitje.

8. Ndëshkohet më shumë se 3 herë brenda një viti kalendarik me një nga sanksionet ligjore.

EMRI:

MBIEMRI:

PËRFAQËSUES I SUBJEKTIT

ADRESA:

E-MAIL:

NR. TELEFONI:

PËRSHKRUANI ANKESËN:
